
Raporti i vlerësimit të cilësisë për vitin akademik 2024/2025
Fakulteti Menaxhmenti
Programi: Menaxhim i Biznesit dhe Ndërmarrësia

- **Hyrja**

Programi **Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia** (MBN) në kuadër të **Fakultetit Menaxhmenti** gjatë vitit akademik 2024/25 ka ofruar mësim për studentet sipas plan-programit të Akredituar 2022/25 nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA). Programi MBN u ofron studentëve njohuri bashkëkohore teorike dhe praktike në fushën e biznesit dhe të menduarit ndërmarrës. Kurrikula e programit MBN është e hartuar në bashkëpunim me industrinë dhe duke i marre përvojat me të mira ndërkombëtare – ajo është përshtatur me trendët zhvillimore në tregun e punës dhe për studentet ofron njohuri, aftësi/shkathtësi dhe kompetenca nga fushat inovacion, financa, ligjet, vendimmarrje biznesore, pastaj fushat ekonomike, menaxhim të projekteve dhe operacioneve, kontabilitet, marketing dixhital, menaxhim ndryshimi, etj, të cilat janë kërkesa edhe nga tregu i punës.

Fakulteti Menaxhmenti ka një staf të kualifikuar dhe ka ambiente moderne të punës të cilat u mundësojnë studentëve të fitojnë aftësitë/shkathtësitë e duhura konformë kërkesave të ekonomisë moderne për profesionin të cilin do ta ushtrojnë në të ardhmen.

Misioni i programit është “të përgatisë kuadro (profesionist) të kualifikuar të cilët përmes metodave të avancuara në menaxhimin e biznesit dhe zhvillimin e ndërmarrësisë do të kontribuojnë në ndryshime pozitive të vazhdueshme të ambientit biznesor”.

Misioni i programit është në harmoni të plotë me **Misionin e Universitetit** “...të përgatisim profesionistë të kualifikuar, hulumtues të përkushtuar dhe qytetarë të edukuar e të përgjegjshëm për të zhvilluar një karrierë profesionale dhe për të udhëhequr një jetë produktive”).

Raporti i vlerësimit të cilësisë nga studentët për vitin akademik 2024/25 përmban të dhëna për vlerësimin e stafit akademik/lëndës, i cili raport krahasohet me dy vitet paraprake.

1. Raporti i përmbledhur i vlerësimit të cilësisë stafi akademik/lënda

Raporti i përgjithshëm - për stafi akademik/lënda - paraqitet në Tabelën nr. 1 – te dhënat për vitin akademik 2024/25 (krahasuar me dy vitet paraprake), i ilustruar edhe ne Fig.1. Pyetjet për dy fushat kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3- Pajtohem pjesërisht; 4- Pajtohem; dhe 5- Pajtohem plotësisht).

Tabela.nr.1 - Vlerësimi i cilësisë sipas tri viteve te fundit - stafi akademik

	Vitet Paraprake		Viti aktual
	2022/23	2023/24	2024/25
Vlerësimi i stafit akademik/lënda	4.23	4.26	4.21




Fig.1 – Grafika - vlerësimi i cilësisë - stafi akademik,

Nga te dhënat e paraqitur në tabelën nr.1 dhe të pasqyruara në grafikun nr.1 në kuadër të fushës te vlerësimi i stafit akademik/lëndës është një vlerësim konstant nga studentët nëpër vitet akademike (2022/23, 2023/24 dhe 2024/25). Duke iu referuar tabelës dhe grafikunit nr.1 për vitin akademik 2024/25 vlerësimi për stafin akademik/lëndën është me notën 4.21 apo rreth 85% është vlerësimi ne përqindje - është një vlerësim i shkëlqyeshëm për punën dhe angazhimin e stafit akademik dhe lëndën e ligjruar.

2. Raporti i vlerësimit te stafit akademik/lëndës

Raporti i vlerësimit për stafin akademik/lëndën në kuadër të programit MBN, paraqet të dhëna për vitin akademik 2024/25 (krahasuar me dy vitet paraprake). Pyetjet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht). Vlerësimi i stafit akademik/lëndës nga studentët është realizuar përmes pyetësorit i cili përmban 11 komponente për te cilat është gjetur nota mesatare. Rezultate e vlerësimit janë paraqitura në tabelën nr.2, nga te dhënat e prezantuara vërejmë se i gjithë stafi akademik/lënda janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, nota mesatare në nivel të programit për mësimdhënës/lëndë është 4.21 një vlerësim i shkëlqyeshëm për punën dhe angazhimin e mësimdhënësve në lëndët përkatëse.

Tabela nr. 2 - Vlerësimi i stafit akademik / lëndës

Nr.	Emri i Lëndëve	Vitet paraprake		Viti aktual
		2022/23	2023/24	2024/25
1	Informatika ne biznes	3.70	4.33	4.60
2	Matematika për biznes	4.11	4.27	4.37
3	Mjedisi Biznesor	4.40	4.45	4.51
4	Hyrje ne ekonomi	4.25	4.51	4.52
5	Shkathtësi akademike dhe komunikim në Biznes	3.10	4.24	4.51
6	Menaxhmenti	4.12	4.31	4.57
7	Vendimmarrja ne Biznes	4.00	4.21	4.28
8	Menaxhimi i Inovacioneve	4.14	4.36	4.48
9	Statistika Biznesore	4.19	3.99	4.45
10	Gjuhe Angleze I	3.95	4.19	4.57
11	Gjuhe Gjermane I	3.90	4.18	4.34
12	Analiza e Tregut dhe Sjellja Konsumatore	///	4.11	4.31
13	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	4.61	3.88	4.00
14	Marketingu	4.77	3.99	4.00
15	Menaxhimi i operacioneve	4.90	3.85	4.19
16	Gjuhe Angleze II	4.28	3.50	3.74
17	Gjuhe Gjermane II	///	4.23	3.97
18	Menaxhimi i dijes	///	4.08	4.15
19	Ndërmarrësi Sociale	///	4.31	///
20	Ndërmarrësia	4.20	3.79	4.19
21	Kontabiliteti	4.13	4.05	4.02
22	E Drejta Biznesore dhe Etika	///	3.97	3.94
23	Sjellja Organizative	4.47	3.92	4.19
24	Gjuhe Angleze III	///	3.40	4.13
25	Gjuhe Gjermane III	///	4.01	3.97
26	Menaxhimi i Sistemit Informativ ne Ndërmarrje	///	4.06	4.25
27	Qëndrueshmëria e Ambientit dhe Ndërmarrësia	///	4.31	4.56
28	Menaxhimi i marrëdhënieve me klientë	///	///	4.09

29	Shitja dhe Menaxhimi i shitjes	///	///	3.89
30	Menaxhimi i Ndryshimeve	///	///	3.90
31	Produkti dhe Vendosja e Çmimeve	4.75	4.36	4.31
32	Menaxhimi strategjik	4.17	4.28	3.90
33	Menaxhimi dhe zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja në ndërmarrje	///	///	4.24
34	Planifikimi Biznisor	///	///	4.16
35	Menaxhimi i projekteve	3.90	4.04	4.07
36	Menaxhimi i Financave	4.27	4.50	4.36
37	Intership (Mësim praktik në ndërmarrje)	///	///	3.84
38	Lidershipi	///	///	4.33
39	NVM	3.75	4.34	4.24
40	Loxhistika dhe Transporti	///	///	3.89
41	Mediat sociale dhe ekonomia dixhitale	///	///	4.28
42	CAD	4.72	///	///
43	Përpunimi i metaleve dhe makinat metalprerëse	3.95	///	///
44	Teknika e matjes	///	///	///
45	Mbrojtja e ambientit	4.71	///	///
46	Praktika profesionale (Ditari i praktikës)	4.17	///	///
47	Hidraulika dhe termodinamika	///	///	///
48	Zhvillimi i produktit dhe proceseve teknologjike	///	///	///
49	Etika në Biznes	4.12	///	///
50	Bazat e të dhënave	4.00	3.97	///
51	Menaxhimi i Cilësisë	4.30	4.24	///
52	Dizajni i Produktit	4.75	4.13	///
53	Teknologjite CNC	4.95	///	///
54	Mbrojtja dhe siguria në Pune	4.50	4.30	///
55	Ri-inxhinjeringu	3.87	///	///
56	E Drejta Biznesore	4.90	4.41	///
57	Menaxhimi i transportit dhe shpërndarjes	3.73	4.42	///
58	E-biznesi	4.15	4.21	///
Mesatarja e përgjithshme		4.23	4.26	4.21

Duke u bazuar në të dhënat e përpunuara nga sistemi SMU (Sistemi i Menaxhimit Universitar) të prezantuara në tabelën nr.2 (vlerësimi i stafit akademik / lëndës), vijmë në përfundimin se ka disa mësimdhënës dhe lëndë të cilat kanë marrë një vlerësim më të lartë - mbi notën 4 - dhe ka disa mësimdhënës dhe lëndë që kanë marrë një vlerësim më të ulët - nën notën 4, në bazë të këtyre të gjeturave rekomandohet që menaxhmenti i programit së bashku me mësimdhënësit dhe komitetin e programit duhet të angazhohen për të rritur nivelin e përgjegjësisë profesionale nga mësimdhënësit në të gjitha lëndët të cilat kanë një vlerësim me notën nën 4, duke bërë përpjekje që këto vlerësime të përmirësohen në vitet pasuese dhe njëkohësisht stafi duhet të mbajë nivelin e mësimi të ato lëndë që janë vlerësuar me notë mbi 4.